

20241692955

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2024

Neni 1

Në Ligjin e Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 283/23), në nenin 20, paragrafët (2), (3) dhe (4) shlyhen.

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen (2), (3) dhe (4).

Paragrafi (8) që bëhet paragraf (5) ndryshohet si vijon:

“Gjatë dorëzimit të kërkesës për punësim në shfrytëzues individual, udhëheqësi i subjektit juridik, dorëzon pasqyrë tabelare që përmban të dhëna për: numrin e të punësuarve me gjendjen 31 dhjetor në tre vitet e fundit, mjetet e planifikuara në masën e pagave, mjetet e paguara nga masa e pagave deri në momentin e paraqitjes së aplikimit për punësim, mjetet e nevojshme për pagesën e pagave deri në fund të vitit për punonjësit ekzistues, mjetet e nevojshme për punësimet e porealizuara për të cilat është lëshuar njoftim paraprak për mjete të siguruara financiare dhe mjete të nevojshme për numrin e kërkuar të punësimeve të reja deri në fund të vitit. Udhëheqësi i subjektit juridik në shtojcë të kërkesës dorëzon edhe deklaratë të nënshkruar, me të cilën vërteton se në kuadër të listës së rrogave ka siguruar mjete për punësimet e kërkuara”.

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

“Gjatë dorëzimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, për plotësimin e vendit të punës në ndërmarrjet publike, agjencitë dhe shoqëritë tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, udhëheqësi i subjektit juridik dorëzon të dhëna financiare dhe të tjera për punësimin e kërkuar si dhe deklaratë të nënshkruar për mjetet e parashikuara për realizimin e të njëjtës në Planin financiar të subjektit juridik për vitin vijues, të miratuar nga organet kompetente në pajtim me ligj”.

Paragrafët (9) dhe (10) shlyhen.

Paragrafi (11) bëhet paragraf (7).

Neni 2

Në nenin 22, paragrafi (2) shlyhet:

Neni 3

Në nenin 24, në paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) fjalët: “Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive” zëvendësohen me fjalët: “Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive”.

Neni 4

Në nenin 31 pas fjalës: “Ekonomi” shtohen fjalët: “dhe Punë”.

Neni 5

Pas nenit 32 shtohet nen i ri 32-a, si vijon:

“Neni 32-a

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 12101 – Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Harpësinor, Nënprogrami AA - Projekte infrastrukturore të komunave, zëri

488 - Dotacionet kapitale për NjVL, shfrytëzohen në bazë të Vendimit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrisë kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet shfrytëzohen në bazë të kritereve të përcaktuara dhe procedurave për ndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, ndërsa pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të realizuara dhe dokumentacionit të plotë të pagesës”.

Neni 6

Në nenin 33 fjalët: “dhe lidhje” shlyhen.

Neni 7

Pas nenit 33 shtohet nen i ri 33-a, si vijon:

“Neni 33-a

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 13001 – Ministria e Transportit, Nënprogrami AA - Projekte infrastrukturore të komunave, zëri

488 - Dotacionet kapitale për NjVL, shfrytëzohen në bazë të Vendimit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrisë kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet shfrytëzohen në bazë të kritereve të përcaktuara dhe procedurave për ndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, ndërsa pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të realizuara dhe dokumentacionit të plotë të pagesës”.

Neni 8

Në nenin 37 fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe Rini”.

Neni 9

Pas nenit 37, shtohet neni i ri 37 -a, si vijon:

“Neni 37-a

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 15001 – Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e Rinisë, Nënprogrami AA - Projekte infrastrukturore të komunave, zëri 488 - Dotacionet kapitale për NjVL, shfrytëzohen në bazë të Vendimit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrisë kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet shfrytëzohen në bazë të kritereve të përcaktuara dhe procedurave për ndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, ndërsa pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të realizuara dhe dokumentacionit të plotë të pagesës”.

Neni 10

Në nenin 38, në paragrafët (1) dhe (2) fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe Rini”.

Neni 11

Në nenin 39 fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe rini”.

Neni 12

Në nenin 40 fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe Rini”.

Neni 13

Në nenin 41 fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe Rini”.

Neni 14

Në nenin 42 fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe Rini”.

Neni 15

Pas nenit 45, shtohet neni i ri 45 - a, si vijon:

“Neni 45-a

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 16001 – Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Nënprogrami AA - Projekte infrastrukturore të komunave, zëri 488 - Dotacionet kapitale për NjVL, shfrytëzohen në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrisë kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet shfrytëzohen në bazë të kritereve të përcaktuara dhe procedurave për ndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, ndërsa pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të realizuara dhe dokumentacionit të plotë të pagesës”.

Neni 16

Pas nenit 46, shtohen dy nene të ri 46 -a dhe neni 46-b, si vijojnë:

“Neni 46-a

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 16101 – Ministria e Sportit, Nënprogrami AA - Projekte infrastrukturore të komunave, zëri 488 - Dotacionet kapitale për NjVL, shfrytëzohen në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrisë kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet shfrytëzohen në bazë të kritereve të përcaktuara dhe procedurave për ndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, ndërsa pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të realizuara dhe dokumentacionit të plotë të pagesës”.

Neni 46-b

Mjetet e përcaktuara në Ndarjen 18010 – Financimi i veprimtarive nga sfera e kulturës, Nënprogrami AA - Projekte infrastrukturore të komunave, zëri 488 - Dotacionet kapitale për NjVL, shfrytëzohen në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrisë kompetente në bashkëpunim me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet shfrytëzohen në bazë të kritereve të përcaktuara dhe procedurave për ndarjen e dotacioneve kapitale nga ministria kompetente, ndërsa pagesa e mjeteve bëhet në bazë të punëve të realizuara dhe dokumentacionit të plotë të pagesës”.

Neni 17

Në nenin 47 në paragrafin (2) fjalët: “Punë dhe Politikë Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Politikë Sociale, Demografi dhe Rini”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.